

## Formulari i vetëdeklarimit të rezidencës tatimore Subjektet/Persona Juridik (CRS)

I/E nderuar klient/e,  
Standardi i Përbashkët i Raportimit për Shkëmbimin Automatik të Informacionit të Llogarisë Financiare (CRS) parashikuar në dispozitat e ligjit nr. 4/2020 "Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarisë financiare", dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 613 datë 29.07.2020 "Mbi Dispozitat Implementuese të Ligjit Nr. 4/2020" ka për qëllim reduktimin e evazionit fiskal që del jashtë kufijve të juridiksioneve pjesëmarrëse. Ky standard i miratuar për zbatim nga Shteti Shqiptar nëpërmjet VKM Nr. 178 datë 09.03.2016, detyron institucionet financiare në vendet pjesëmarrëse (përfshirë bankat në Shqipëri) të identifikojnë dhe raportojnë llogaritë financiare të mbajtura nga subjektet me adrese/vend ushtrimi aktiviteti/regjistrim për qëllime tatimore në një nga vendet pjesëmarrëse.

Në zbatim të kuarit ligjor të përmendur më sipër dhe për t'i mundësuar Bankës Kombëtare Tregtare sha të respektojë detyrimet raportuese, duhet të jepni/deklaroni informacion të plotë në lidhje me rezidencën tatimore të subjektit, numrat e identifikimit për qëllime tatimore/kodin fiskal, klasifikimin sipas rregullave tatimore, si dhe informacionin mbi rezidencën për qëllime tatimore për personat kontrollues, që kontrollojnë drejtpërdrejt ose indirekt 25% ose më shumë të aksioneve ose votave të subjektit ose sipas përcaktimeve të kuarit ligjor për trustet dhe subjektet pa pronar përfitues individ, në rast se subjekti është NFE Pasive ose një entitet investimesh i themeluar në një juridiksion jo-pjesëmarrës dhe menaxhohet nga një institucion tjetër financiar.

**Ju lutemi të mbani parasysh sa më poshtë:**

- Ky formular kërkohet të plotësohet vetëm për subjektet nga përfaqësuesit ligjor respektive.
- Bankës Kombëtare Tregtare Sh.A. (BKT) **nuk i lejohet** të plotësoj këtë formular për emër të subjektit.
- Në rast se janë paraqitur ose disponohen të dhëna që tregojnë një rezidencë të huaj tatimore banka disponon të drejtën për të kërkuar dokumentacion ose informacion shtesë me qëllim verifikimin e rezidencës tatimore. Në rast të mos pranimit nga ana e klientit për të plotësuar këtë formular ose për të dërguar dokumentacionin / informacionin shtesë të kërkuar, BKT mund të jetë e detyruar që të refuzojë hapjen e llogarisë ose të mbyllë llogarinë ekzistuese.
- **Nëse të dhënat e deklaruara në seksionin I, II, IV, V ndryshojnë, atëherë subjekti duhet t'i sigurojë Bankës Kombëtare Tregtare një vetëdeklarim të ri brënda 90 ditëve.**
- Nëse keni pyetje lidhur me plotësimin e këtij formulari, përcaktimin e rezidencës tuaj tatimore ose mënyrën e klasifikimit të subjekteve ju lutemi vizitoni faqen zyrtare të OECD-së ose konsultohuni me një konsulent fiskal/autoritetet tatimore lokale.

Për më shumë informacion ju lutem vizitoni faqen zyrtare të internetit [www.oecd.org](http://www.oecd.org) ose <https://www.tatime.gov.al/c/6/455/shkembimi-automatik-i-informacionit>

**SEKSIONI I - Të dhënat e subjektit (Ju lutem plotësoni saktë të dhënat e mëposhtme me GËRMA KAPITALE)**

<b>Emri Juridik i subjektit/degës:</b>	
<b>Vendi i themelimit:</b>	
<b>Adresa e rezidencës tatimore të subjektit:</b> (Ketu duhet të vendosni adresën e rezidencës tatimore)	1. Rruga: _____ 2. Qyteti: _____ 3. Shteti: _____ 4. Kodi Postar; _____

**SEKSIONI II - Vendi i rezidencës për qëllime tatimore**

Nëse subjekti është rezident tatimor edhe në vende të tjera përveç Shqipërisë, ju lutem listoni këto vende si dhe listoni numrat e identifikimit të subjektit/numrin e identifikimit tatimor në këto vende.

**Nëse një TIN nuk është i disponueshëm** - ju lutemi jepni arsyen e duhur

Vendi i Rezidences Tatimore	NIPT/TIN/Numri i Identifikimit tatimor	NIPT/TIN i padisponueshem (shpjegimi i arsyeshem vetëm nëse nuk ka TIN/Numër Identifikimi Tatimor)
<b>1</b>		
<b>2</b>		
<b>3</b>		

**SEKSIONI III - Klasifikimi i subjektit sipas kuadrit ligjor Tatimore mbi Llogaritë e Huaja (CRS-së) (Ju lutem zgjidhni vetëm kutinë përkatëse të zbatueshme):**

1. Nëse subjekti është një institucion Jo-financiar (NFE), ju lutem të zgjidhni kutinë përkatëse të zbatueshme:

❖ **ENTITET AKTIV JO-FINANCIAR (NFE/NFEE Aktive)**

A. Njësi ekonomike që kryen aktivitet operacional

B. Korporata, aksionet e së cilës tregtohen rregullisht në një ose më shumë tregje të organizuara të letrave me vlerë ose një entitet të lidhur me të.

C. Ent qeveritar ose Bankë Qendrore

D. Organizatë Ndërkombëtare

E. Subjekt në likuidim

F. Subjekti i angazhuar në financimin dhe mbrojtjen e transaksioneve (Hedge fund) të subjekteve të lidhura (Grupi jo-FI)

G. Subjekti i krijuar vetëm për qëllime fetare, bamirëse, shkencore, artistike, kulturore, sportive ose arsimore

(Nëse keni zgjedhur një nga opsionet e mësipërme kaloni në plotësimin e Seksionit VI)

❖ **ENTITET JO-FINANCIAR PASIV (NFE/NFEE Pasiv)**

A. NFE/NFEE Pasive (jo aktive)- shpjegimi ne Shtojcë

(Nëse Subjekti është një NFE Pasive kaloni në plotësimin e Seksionit IV dhe V)

(Nëse Subjekti është një NFE Pasive duhet të plotësohet dhe forma W8-BEN-E në lidhje me kërkesat sipas FATCA)

2. Nëse subjekti është një institucion financiar, ju lutem zgjidhni kutinë e zbatueshme përkatëse:

A. **Institucion Financiar Raportues**

B. **Institucion Financiar Jo-raportues**

**SEKSIONI IV – Deklarimi i Personave Kontrollues (Ju lutem plotësoni saktë vetëm në rastet kur Personi Juridik është identifikuar si NFE/NFEE Pasive si në seksionin III.)**

Emër, Mbiemër i Personit Kontrollues	Vendi i Rezidencës Tatimore	Numri i Identifikimit Tatimor/TIN
1.		
2.		
3.		

**SEKSIONI V – Të dhënat identifikuese të personave kontrollues të deklaruar në SEKSIONIN IV. (Ju lutem plotësoni saktë të dhënat e mëposhtme me GËRMA KAPËTALE.)**

**PERSONI KONTROLLUES (1)**

**Atësia e personit kontrollues:**

**Adresa e Personit Kontrollues:**

1. Rruga:  
.....
2. Qyteti  
.....
3. Shteti  
.....

	4. Kodi Postar .....
<b>Datëlindja:</b>	___/___/___
<b>Vendlindja:</b>	1. Qyteti i Lindjes: ..... 2. Vendi (Shteti): .....
<b>PERSONI KONTROLLUES (2)</b>	
<b>Atësia e personit kontrollues:</b>	.....
<b>Adresa e Personit Kontrollues:</b>	1. Rruga: ..... 2. Qyteti ..... 3. Shteti ..... 4. Kodi Postar .....
<b>Datëlindja:</b>	___/___/___
<b>Vendlindja:</b>	1. Qyteti i Lindjes: ..... 2. Vendi (Shteti): .....
<b>PERSONI KONTROLLUES (3)</b>	
<b>Atësia e personit kontrollues:</b>	.....
<b>Adresa e Personit Kontrollues:</b>	1. Rruga: ..... 2. Qyteti ..... 3. Shteti ..... 4. Kodi Postar .....
<b>Datëlindja:</b>	___/___/___
<b>Vendlindja:</b>	1. Qyteti i Lindjes: ..... 2. Vendi (Shteti): .....
<b>SEKSIONI VI – Autorizime dhe Nënshkrimi</b>	
<b><u>Autorizime dhe angazhime</u></b>	
<i>Mbajtësi i llogarisë pranon se çdo informacion që përmban ky vetëdeklarim dhe çdo informacion në lidhje me llogaritë e tij financiare aktuale dhe të ardhshme, duke përfshirë balancën e tyre dhe transaksionet e të ardhurave, mund t'i raportohen (i) çdo autoriteti të cilit BKT duhet t'i japë informacione tatimore, (ii) çdo pale tjetër që BKT e konsideron si të nevojshme për të vepruar në përputhje me rregulloren në zbatim të CRS dhe për të parandaluar shkeljet e mundshme dhe (iii) shoqërisë mëmë, në kuadër të implementimit të detyrimeve që rrjedhin nga CRS pranë filialeve të saj.</i>	
<b><u>Deklarata dhe nënshkrimi</u></b>	
<i>Konfirmoj se të gjitha deklaratat e bëra në këtë formular vetëdeklarimi, në dënimin time, janë të sakta dhe të plota. Vërtetoj se jam personi i autorizuar për të nënshkruar për mbajtësin e llogarisë, për të gjitha llogaritë e përmendura në këtë formular Deklaratë.</i>	

Konfirmoj që informacioni i dhënë më lart është i vërtetë, i saktë dhe i plotë si dhe deklaroj se unë marr përgjegjësi të plotë për informacionin e paraqitur më lart.

Pranoj se brenda **90 ditëve** nga ndryshimi i rrethanave do të dorëzoj pranë Bankës një formular të ri vetë deklarimi nëse ndonjë informacion në këtë formular ndryshon ose është i pasaktë, përfshirë edhe informacionin për personat kontrollues.

**Firma e Përfaqësuesit ligjor të Klientit:** ..... **Data:** / /

**SEKSIONI VII – Nënshkrimi i stafit të bankës (Për t'u plotësuar nga Banka)**

**Dega:**

**Emër, Mbiemër dhe Firma e Stafit që merr në dorëzim Formularin:**

**Vula e Degës:**

**ANEKS: PËRKUFIZIME**

**"Pronar Perfitues/Person Kontrollues"** - Kontrolli mbi një subjekt ushtrohet përgjithësisht nga individ (personi fizik) i cili zoteron zotëron në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë një përqindje të caktuar (psh.25 %) të aksioneve ose të votave të një personi juridik ose organizimi ligjor; Nese nuk arrihet të identifikohet asnjë individ i cili ushtron kontrollin nëpërmjet të drejtave të pronësisë atëherë sipas kërkesave të CRS-se duhet raportuar individ që mban postin e përfaqësuesit ligjor/administratorit të kompanisë. Në rast të një subjekti të tipit Trust atëherë person kontrollues do të konsiderohet (administratori, ruajtësi/I besuari për mirëmbajtjen e trustit, përfituesi/it ose tjetër kur aplikohet).

**"Numër i Identifikimi të Tatimpaguesit"** - Numri i Identifikimit të Tatimpaguesit është një kombinim unik i shkronjave ose numrave të caktuar nga një juridiksion për një person fizik ose juridik. Ai përdoret për të identifikuar personin për qëllime të administrimit dhe identifikimit tatimor. Disa juridiksione nuk lëshojnë një TIN / Numri i Identifikimit të Tatimpaguesit. Megjithatë, këto juridiksione përdorin shpesh një numër tjetër të barasvlershëm identifikimi për efekt identifikimi tatimor. (Shënim: për Individet në Shqipëri do të konsiderohet numri i Sigurimeve Shoqërore, ndërsa për Personat Fizik dhe Juridikë do të konsiderohet NIPTI-Numri i Identifikimit të Personit të Tatuësëm).

**"Vendi i Rezidencës për Efekt Pagimi të Taksave"** - Një person mund të jetë subjekt tatimesh në më shumë se një vend, në varësi të ligjeve dhe rregulloreve të vendeve të veçanta. Në përgjithësi, vendi i rezidencës tatimore të një personi është ai i vendbanimit të përhershëm të personit ose vendit primar të banimit. Megjithatë, secili vend ka rregullat e veta për përcaktimin e vendbanimit tatimor. **Nëse keni pyetje që lidhen me përcaktimin e rezidencës tatimore ju lutemi vizitoni faqen e zyrtare të OECD-së, konsultohuni me një konsulent fiksial ose autoritetet tatimore lokale .** <http://www.oecd.org/ctp/exchange-of-tax-information/standart-for-automatic-exchange-offinancial-information-in-tax-matters.htm>

**"NFE"** - çdo njësi ekonomike / subjekt që nuk është një institucion financiar.

**"NFE Pasive (Non-Financial Entity)"** - është çdo NFE që nuk është një NFE aktive ose Njësi ekonomike që nuk është një Institucion Financiar i Juridiksionit Pjesëmarrës

**"NFE/NFEE Aktive"** - Njësi ekonomike (NFE/NFEE) që plotëson të paktën një nga kriteret e mëposhtme:

- Subjekti që kryen biznes operativ: Më pak se 50% e të ardhurave bruto të NFE-së në vitin kalendarik të mëparshëm janë të ardhura pasive, dhe më pak se 50% e aktiveve të mbajtura nga NFE gjatë një viti kalendarik të mëparshëm janë pasuri që prodhojnë ose janë të mbajtura për prodhimin e të ardhurave pasive;
- Korporata, aksionet e së cilës tregtohen rregullisht në një treg të themeluar të letrave me vlerë ose një entitet të lidhur me të: aksionet e NFE tregtohen rregullisht në një treg të themeluar të letrave me vlerë ose NFE është një entitet i lidhur i një entiteti, stoku i të cilit është rregullisht tregtohet në një treg të krijuar letrave me vlerë;
- Entitet Qeveritar, Banka Qendrore ose Organizatat Ndërkombëtare: një bankë qendrore ose një person juridik që është pronari i vetëm i një ose më shumë institucioneve të lartpërmendura. Termi "Organizatë Ndërkombëtare" nënkupton organizata ndërqeveritare (përfshirë një organizatë ndërkombëtare), të cilat përbëhen kryesisht nga qeveritë, që ka në fuqi një seli ose një marrëveshje thellësisht të ngjashme me juridiksionin dhe të ardhurat e të cilave nuk sigurohen në dobi të personave private;
- fond investimi, i tillë si fond privat me kapital neto, fond me sipërmarrje kapitali, fond blerjeje me financim nga të tretë ose çdo instrument investimi, qëllimi i të cilit është blerja ose financimi i shoqërive dhe më pas mbajtja e interesave në ato shoqëri si aktive kapitali për qëllime investimi;
- NFE-ja nuk ka qenë një institucion financiar në pesë vjetët e fundit dhe është në procesin e likuidimit të aktiveve të saj, ose po riorganizohet me qëllim vijimin ose rifillimin e operacioneve në një biznes të ndryshëm nga ai i institucionit financiar;
- Kompani e angazhuar në financim dhe mbrojtjen e transaksioneve për Njësitë Ekonomike të Lidhura: NFE-ja angazhohet kryesisht në financimin dhe mbrojtjen e transaksioneve me, ose për, Njësitë Ekonomike të Lidhura që nuk janë Institucione Financiare, dhe nuk i ofron hërbime financimi ose mbrojtjeje asnjë Njësie Ekonomike që nuk është Njësi Ekonomike e Lidhur, me kusht që grupi i çdo Njësie të tillë Ekonomike të Lidhur është kryesisht i angazhuar në një biznes të ndryshëm nga ai i Institucionit Financiar;
- Subjekti i kushtuar veçanërisht për qëllime fetare, bamirësie, shkencore, artistike, kulturore, sportive ose educative

**"Institucion Financiar"** - është një Institucion Kujdestarie, një Institucion Depozite, një Njësi Ekonomike Investimesh ose një Shoqëri Sigurimesh Specifike

**FATCA (Foreign Tax Compliance Act)** - Akti i Përputhshmërisë së Tatimeve në Llogaritë e Huaja është një legjislacion i Departamenti të Thesarit të USA i cili ka hyrë në fuqi në korrik 2014. FATCA kërkon që institucionet e huaja financiare (FFI) t'i raportojnë IRS informacione në lidhje me llogaritë financiare të mbajtura nga taksapaguesit amerikanë, ose nga subjektet e huaja në të cilat taksapaguesit amerikanë kanë një interes të konsiderueshëm pronësie. Për më shumë info mund të drejtoheni në faqen: <https://www.irs.gov/businesses/corporations/foreign-account-tax-compliance-act-fatca>